



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

PROCESVERBAL

KONSULTIMIT PUBLIK

DHËNIE PËLQIMI NË PARIM, PËR DHËNIE ME QIRA TË PASURISË NR 155/1, TË LLOJIT PYLL (CUNGISHTE), PJESE TË SAJ, PËRKATËSISHT SIPËRFAQEN 0,5 HA DHE 0,2 KM RRUGE, PJESE E PASURISË NË FSHATIN DRINAS NJËSIA ADMINISTRATIVE KOLSH, BASHKIA KUKËS. FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS QË JEPET ME QIRA TS JETS: “PËR QËLLIME PUSHIMI, ARGËTIMI, KËNDE LOJRASH,SHLODHESE ETJ)

Me datë 27.06.2024, ora 10:00, në lagjen Drinas, u zhvillua seanca e konsultimit publik sipas njoftimit të datës 07.06.2024.

Nga ana e Këshillit Bashkiak morën pjesë: A.M, H.P, S.M, G.H.

Nga ana e bashkisë morën pjesë: S.H (Drejtor i Pyjeve dhe Kullotave), specialist të kësaj drejtorie, administrator i njësisë Kolsh.

Takimi hapet nga kryetari i Këshilli Bashkiak, i cili prezanton para banorëve të pranishëm projektvendimin. Bëhet fjalë për një sipërfaqe që do të jepet me qira për qëllime pushimi. Kryetari i fshatit është i pranishëm.

Banor i fshatit: Ne kemi ardhur në këtë takim pas njoftimit që kemi marrë . Jemi banorë që kufizohemi me sipërfaqen që do të jepet me qira. Nuk kemi probleme.

Banor tjetër: Ndoshta sot duhet të ishim më shumë banorë.

Njoftimi ka qenë publik. Pjesëmarrja është me dëshirë.

Kufitarët e zonës janë: Z.O, T.O, karburanti i shtetit dhe rruga. Aty janë zabelet. Nuk duam probleme me rrugën. Do e përdorim bashkërisht. Përndryshe nuk ka asnjë pengesë nga ana jonë. Nuk ka diskutime apo sugjerime të tjera.